

URDHËR
Nr. 131, datë 8.3.2020

PËR NDALIMIN E EKSPORTIT TË BARNAVE DHE TË PAJISJEVE MJEKËSORE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, pika 3, germa “c”, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”; të vendimit të datës 8.3.2020 të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri”, si edhe në përputhje me Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit, me qëllim marrjen e masave për mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkatuar nga COVID-2019,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e eksportit të barnave dhe të pajisjeve mjekësore nga Republika e Shqipërisë deri në një urdhër të dytë.
 2. Eksporti i barnave dhe i pajisjeve mjekësore do të kryhet vetëm me autorizim të posaçëm të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
 3. Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore të ndërmarrë të gjitha veprimet në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, për zbatimin e këtij urdhri.
 4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore dhe të gjitha subjektet që kryejnë eksport të barnave dhe pajisjeve mjekësore nga Republika e Shqipërisë.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu